



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:097956

Datë: 21.02.2025

Numri i dokumentit: 06885334

P.nr.122//2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Raci, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtores profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit B B nga fshati G-K.K i akuzuar për veprë penale ‘‘Vjedhje e shërbimeve, nga neni 314 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.860/2022 të datës 13.05.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, të mbajtur në praninë e Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të pandehurit B B, me datë 20.01.2025, ndërsa me dt.21.02.2025 e përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

Të pandehurin B B i lindur më dt., në fshatin G-K.K, ku dhe tani banon, me numër personal të letërnjoftimit , i biri i K B dhe nënës V B, i pa punë, i pa lëvizshëm, i nacionalitetit shqiptar shtetas i Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë e gjerë me dt.30.08.2021 në shtëpin e tij në fshatin G-K.K, me qëllim që vetes ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmangë pagesën për shërbime të tilla , në atë mënyrë që pas kontrollit të ekipit profesional të KEDS-it, në njehsorin elektrik e në shtëpi , me këtë veprim e ka anashkaluar njehsorin elektrik , i cili e kishte për ta matur shpenzimin e kilovatëve të konsumuar ku të gjeturat në vendin e ngjarjes tek i pandehuri janë përshkruar në procesverbal me nr.2176762 të dt.26.04.2022 , ashtu që në mënyrë të paautorizuar ka shpenzuar energjin

elektrike , me ç rast sipas provave që ka prezantuar e dëmtuara KEDS, të njëjtës i ka shkaktuar humbje në vlerë prej 308.66 Euro.

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së,

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 46, 47,48, 50,51,52, 69 dhe 70, dhe neni 314 par.1 dhe 367 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364, të KPPRK-së:

GJYKON

DËNIM ME KUSHT

I.Ashtu që të pandehurin B B, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprën tjetër penale.

II.Dënimimi me kusht do të revokohet nëse i pandehuri kryen veprën penale mbrenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti konform nenit 50 të KPRK-së.

III.LIROHET: i Pandehuri nga shpenzimet për shkakë të gjendjes së dobët ekonomike.

IV. Udhëzohet pala e dëmtuar KEDS-ë në Pejë, që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykata ka paraqitur aktakuzën kundër të pandehurit B B, nga fshati G K.K për veprën penale,, Vjedhje e shërbimeve,, nga neni 314 par.1 të KPRK-së me numër PP/II nr.860/2022 të datës 13.05.2022.

Kompetenca e gjykatës , Gjkata para se të caktoj shqyrtimin fillestar në vështrimin e aktakuzës ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore, sa i përket kompetencës territoriale për të gjykuar një çështje juridiko-penale ku gjykata në territorin e së cilës është kryer apo është tentuar të kryhet vepra penale, apo në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja.Në rastin konkret vepra penale është kryer në Klinë, andaj Gjkata Themelore në Pejë-Dega në Klinë ka kompetencë territoriale në gjykimin e kësaj çështje penale.

Gjkata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt.20.01.2025. gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, i pandehuri B B.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar pranojë fajësinë për veprën penale në aktakuzë që më vihet në barrë, jam i penduar thellë për veprën që e kam kryer, i premtojë Gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të ngjajshme penale, por për shkak të gjendjes së dobët ekonomike kam qenë i detyruar që të kyqem direkt në rrjetin elektrik, kjo deklaratë iu muar në oborrin e gjykatës në veturë, pasi i pandehuri është i sëmurë i palëvizshëm, kjo deklaratë është vënë në procesverbal.

Gjykata kërkon mendimin e Prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se pasi që i pandehuri e pranoi fajësinë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të tillë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresë të lëndës, i propozon gjykatës që të pranojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale që i vihet në barrë, dhe me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me dënimin, pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i pandehuri B B , për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 par.1 dhe 2 të KPRK-së. Në këtë aspekt Gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e qështjës që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit të lartëcekur qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale ‘‘Vjedhje e shërbimeve ‘‘ nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, Gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPRK-së. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale të

lartecekur, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, e që kjo rrethanë e cila duke i ndërlidh me rrethanat tjera, si fakt se i njëjti është penduar për veprën penale, si rrethanë posaqerisht lehtësuese gjykata muar se i pandehuri është i sëmure dhe i palëvizshëm, të cilit edhe deklarata iu muar në veturë në oborr të gjykatës, i njëjti ka premtuar se nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme në të ardhmën. Ndërsa, gjykata si rrethanë rënduese nuk gjeti asnjë rrethanë.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshen e vepres penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 tre muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhen verifikuese prej 1 një viti nuk kryen vepra të re penale.

Andaj duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë në harmoni me peshen e vepres penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për lirim nga shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 452 par.4 të KPRK-së

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe neneve 364 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.205/2022 me datë.21.11.2024

Gjyqtarja gjykuese

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrajnë ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.